



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odelenje za Opštu Upravu

III. Nr. i prot. 4138 Më 13-10 2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 5 lidhur me nenin 12 dhe 22 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike të gjithë përpunuesit e pemëve dhe perimeve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda territorit të Komunës së Rahovecit, të aplikojnë për të përfituar nga skema e mbështetjes e cila do të ofrohet përmes subvencioneve me mjete financiare.

Qëllimi

Në vitet e fundit përpunimi i produkteve bujqësore ka ndikuar në masë të madhe në ndaljen e importit të pemëve dhe perimeve nga shtetet fqinje, duke kontribuar në të ardhurat e kënaqshme dhe siguri më të madhe për prodhuesit vendor. Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për përpunuesit e pemëve dhe perimeve, që bëjnë përgatitjen, ruajtjen dhe konservimin e tyre duke nxjerur nënproduktet, sikurse janë: reqelnat, turshit etj. Si pasojë e situatës së krijuar në vend nga virusi COVID-19, këtyre bizneseve u janë shkaktuar humbje të mëdha në ekonomitë e tyre familjare, duke pasur parasysh stoqet e krijuara për shkak të mungesës së tregut gjatë kësaj periudhe.

Bizneset përpunuese të pemëve dhe perimeve - në kuadër të së cilës bëjnë pjesë:

- Grumbullimi i pemëve dhe perimeve
- Përpunimi i produkteve bujqësore,
- Ruajtja dhe konservimi i pemëve dhe perimeve
- Fuqizimin e eksportit
- Rritjen e numrit të punetoreve

Specifikat e tjera të thirrjes publike

- **Thirrja publike për aplikim hapet më 13.10.2020 dhe mbyllet më 27.10.2020**
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i subvencionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën përfitues të subvencionit do të nënshkruhet një kontratë përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

- Perfituesi ne fund te vitit eshte i obliguar qe te sjell raport detal per sasinë e grumbulluar te pemëve/perimeve

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit,
- Kopja e letërnjoftimit të pronarit
- Konfirmimi i llogarisë bankare ne emër te biznesit
- Listën e numrit te punetoreve te deklaruar ne ATK
- Deklaratat e TVSH-së (per vitin 2019 dhe nga janari deri ne shtator 2020)
- Listen e fermere nga të cilët ka pranuar produkte bujqesore per vitin 2020

Kategorizimi i subvencionimit - kriteret

Përmes kësaj thirrje subvencionet do te ndahen ne 3 kategori:

1. Kategoria e parë
 - Bizneset qe kanë të regjistruar mbi 10 punëtor,
 - Bizneset qe kanë grumbullur me shume se 200,000 kg te perimeve (lloje te ndryshme)
 - Bizneset qe gjatë vitit 2020 kanë realizuar së paku eksport në shtet e jashtme
2. Kategoria e dytë
 - Bizneset e regjistruara nga 2 deri në 9 punëtor
 - Bizneset që kanë grumbulluar më shumë se 100,000 kg të perimeve (lloje të ndryshme)
3. Kategoria e tretë
 - Ekonomitë familjare që gjatë vitit 2020 kanë arritur të përpunojnë mbi 300 kg të produkteve si: Pekmez, Pestil, Reqel etj.

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në katin e parë në objektin e Komunës.

